

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Zabeli i kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vjollca Kurtishaj , procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.V. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit S.V., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1960/2017 të datës 21.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.05.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit S.V., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr. 1960/2017 të datës 21.12.2017, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.3092/2016 të datës 19.04.2017, të akuzuarin S.V. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 të KPRK-së për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e të cilin nuk do ta mbaj po që se i akuzuari në afat prej 2 vitesh nuk kryen vepër të re penale. I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas kësaj llogarie dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari Sh.B., për realizimin e dëmit të shkaktuar udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari S.V., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.359/2018, datë 25.04.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesa, gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Në ankesën e të akuzuarit, pretendohet se me nxerrjen e këtij vendimi gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ngase ka neglizhuar zbatimin e parimit të disponibiliteti dhe pranimin e provave të paraqitura nga ana e të pandehurit të cilat prova dëshmojnë pafajësinë e tij, gjithashtu në mënyrë të imponuar dhe të frikësuar kanë shtyrë të pandehurin që e pranojnë fajin, kjo si rezultat i kërcënimeve për dënime me maksimale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPK-së apo shkelje të tjera të cilat gjykata e shkallës së dytë në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së i vëren detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Kështu, me aktgjykimin e ankimuar, pra edhe dispozitivi i tij është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, nuk përmban kundërthënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Përshkrimi i dhënë në dispozitiv i përmban të gjitha arsyet, faktet relevante të cilat janë dhënë në mënyrë koncize, kështu që në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënie ose dubioze. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale, e të cilat arsye si të drejta dhe të ligjshme i mbështet edhe kjo gjykatë, sepse kanë mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesën e parashtruar pretendohet se Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i pa bazë dhe jo ligjor ngase i njëjti është i bazuar në deklaratat të rrejshme dhe i pa bazuar në fakte relevante, ngase deklaratat e dëshmitarit dhe palës së dëmtuar se kinse dëmtimi i pasurisë është shkaktuar nga ana e bagëtisë së të akuzuarit dhe se në fshat askush tjetër nuk ka bagëti përveç të akuzuarit, nuk janë vërtetuar fare me ndonjë raport apo ekspertizë apo fotografim të bagëtisë, të cilat mund të dëshmonin faktet e cekura dhe se gjithë çka është sajuar nga zyrtari policor, ndaj të cilit i akuzuari ka ushtruar ankesë në Inspektoratin policor të Kosovës. Sipa ankesës, si rezultat i shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka zbatuar gabimisht edhe ligjin penal.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të të akuzuarit, nuk qëndrojnë. Sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesa. Se i akuzuari S.V. e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është gjykuar në pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë, dhe se kjo është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarit-të dëmtuarit Sh.B. dhe foto dokumentacionit që gjindet në shkresa të lëndës. Sipas dëshmisë së të dëmtuarit, ditën kritike i njëjti ka qenë në Prishtinë por nga axha i tij, M. është njoftuar përmes telefonit se lopët e tani të akuzuarit kanë hyrë në pronën e tij dhe i kanë dëmtuar fasulet që i kishte mbjellur në sipërfaqe prej 13 arl, se me bagëti nuk kishte qenë tani i akuzuari por edhe askush tjetër, se axha i të dëmtuarit i ka larguar lopët nga prona e të dëmtuarit, me ç'rast i ka numëruar 60 lopë dhe se është i sigurt se lopët janë pronë e tani të akuzuarit sepse i njëjti në atë regjion është i vetmi që ka lopë. Bazuar në shkresa të lëndës kjo nuk ka qenë hera e parë që bagëtia e të akuzuarit i ka shkaktuar dëme të dëmtuarit dhe se për këtë, ka qenë e njoftuar edhe policia, e cila ditën kritike ka ardhur në vendin e ngjarjes dhe ka bërë fotografimin e dëmeve, e që ky foto dokumentacion është në shkresa të lëndës, prandaj, edhe ky kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka dhënë besimin dëshmisë së të dëmtuarit dhe fotodokumentacionit.

Prandaj, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se në veprimet e të akuzuarit Smajl Krasniqi përmbushen të gjitha tiparet e veprës penale për të cilat akuzohet, janë të drejta dhe të ligjshme. Andaj, me qenë se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, del se drejtë është aplikuar edhe ligji penal kur i akuzuari është shpallë fajtor për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 të KPRK, e cila i vihet në barrë me akuzë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, ankesa e të akuzuarit në këtë drejtim është e mangët, I akuzuari nuk ka theksuar asnjë arsye lidhur me këtë bazë ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e të akuzuarit për lirimin e tij nga akuza, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar faktin se ka pasur sjellje korrekt, semë pare nuk ka qenë I dënuar, pendimin e sigurtë, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke

aplikuar dispozitën e nenit 73 të KPPK, duke vlerësuar faktin se në ankesën e të akuzuarit nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PA1.nr.350/18, datë 23.05.2018,

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Vjollca Kurtishaj

Kryetar i kolegjit-gjyqtari  
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:  
Shqipe Qerimi  
Afrim Shala